



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

MBI DIGJITALIZIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE VENDORE PËR BIZNESIN

Tiranë, Mars 2025

SHKURTIME

ALL	Lek Shqiptar
AmCham	Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe Industrisë
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ATV	Administrata Tatimore Vendore
AZRT	Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale
AZHT	Agjencia për Zhvillimin Territorial
BE	Bashkimi Evropian
DIHA	Dhoma Gjermane e Tregtisë
DPTP	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë
DPTTV	Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore
EJL	Evropa Jug-Lindore
FIAA	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri
KB	Këshilli Bashkiak
KI	Këshilli i Investimeve
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MF	Ministria e Financave
NVM	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
PBB	Produkt i Brendshëm Bruto
PEFA	Llogaridhënia për Shpenzimet dhe Financat Publike
PVZh	Planet Vendore të Zhvillimit
TEDA	Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Ky dokument pune është përgatitur në kuadër të Mbledhjes XXXVI të Këshillit të Investimeve nga ekspertët e Sekretariatit të Këshillit të Investimeve, znj. Elida Fara, eksperte Ekonomike, z. Elvis Zerva, Ekspert Ligjor dhe Rregullator, znj. Xaira Shurdha, Eksperte Monitorimi dhe Ndërlidhjes, si dhe me kontributin e ekspertës se jashtme, znj. Adelina Farriçi, nën drejtimin e Drejtores së Sekretariatit, Dr. Diana Leka [Angoni]. Mbështeti në redaktimin gjuhësor të materialit, znj. Elisa Lula, Oficere Administrative dhe Komunikimit në Sekretariat.

Falenderojmë për bashkëpunimin në procesin e konsultimit Ministrinë e Financave, Bashkinë e Durrësit, Bashkinë e Elbasanit, Bashkinë e Korçës, Bashkinë e Kolonjës, Bashkinë e Lushnjes, Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave – Bashkia Tiranë, Shoqatën e Ndërtuesve, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Shoqatën e Ndërmjetësuesve të Pasurive të Paluajtshme (NAREA), si dhe 163 kompanitë që iu përgjigjën anketës, për bashkëpunimin e tyre të çmuar në përgatitjen e këtij materiali.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJJE.....	5
METODOLOGJIA.....	7
KONTEKSTI.....	8
KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL.....	11
PROBLEMATIKA TË EVIDENTUARA.....	13
Problematika të referuara nga biznesi gjatë 2015-2024.....	13
Gjetje dhe analiza.....	14
Kadastra fiskale, progresi dhe statusi aktual.....	24
REKOMANDIME.....	26
BIBLIOGRAFIA.....	29
PYETËSOR.....	30

HYRJJE

Digjitalizimi i shërbimeve publike në Shqipëri konsiderohet si një nga reformat institucionale të mirëqeverisjes më të suksesshme. Ky progres tashmë i evidentuar në disa raporte ndërkombëtare,¹ i referohet indikatorëve² që konsiderojnë jo vetëm nivelin e aksesit, por edhe monitorojnë cilësinë e shërbimeve digjitale që u ofrohen qytetarëve dhe bizneseve. Që nga 1 maj 2022, pjesa më e madhe e shërbimeve publike qendrore ka kaluar online nëpërmjet platformës qeveritare e-Albania. Qëllimi kryesor është lufta ndaj korrupsionit, efënca e shërbimeve administrative dhe inkurajimi i një niveli më të lartë gjithëpërfshirje në mirëqeverisjen e institucioneve të vendit. Në kuadrin e proceseve integruese, angazhimi politik dhe fokusi ndaj digjitalizimit evidentohet në disa dokumenta politikash dhe plane të qeverisë qendrore, si për shembull Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030 si edhe Agjenda Digjitale 2022-2026, që promovojnë rritjen e aksesit të teknologjive digjitale dhe mbrojtjen e të dhënave në koherencë me standartet e Bashkimit Evropian (BE). Ndër-

kohë këto dokumenta konsiderojnë edhe kalinin e shërbimeve administrative nga formatet tradicionale në ato digjitale edhe në *nivel vendor duke evidentuar angazhimin dhe nevojën për investime paraprake në teknologji, burime njerëzore dhe dije e ekspertizë si nga pushteti vendor ashtu edhe nga sektori privat*. Referuar raporteve të vlerësimit mbi pushtetin vendor, problematikat në lidhje me digjitalizimin lidhen jo vetëm me infrastrukturën, veçanërisht në zonat malore por edhe me kapacitet e limituara të bashkive në drejtim të a) investimeve në teknologji apo platforma bashkëkohore online, b) përpunimit dhe menaxhimit të të dhënave, c) cilësisë së burimeve njerëzore si edhe niveleve të sigurimit të gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies.³ Aktualisht, panorama kombëtare e shërbimeve digjitale në nivel vendor paraqitet e fragmentuar dhe ofrimi i një aksesit digjital të barabartë si për qytetarët ashtu edhe për bizneset mbart mjaft sfida duke evidentuar një boshllëk në krahasim me shërbimet e digjitalizuara në nivel qendror. Në këtë analizë, synojmë të evidentojmë pritshmëritë e biznesit kundrejt transformimit digjital të shërbimeve vendore. Ndër-

1 https://www.sigmaweb.org/en/publications/public-administration-in-albania-2024_5577d117-en.html
2 https://www.sigmaweb.org/en/publications/public-administration-in-the-western-balkans-2024_1ec4c18f-en.html

3 *Assessing Municipal and Public e_Readiness in Albania, February 2024 IDRA*

kohë, është miratuar edhe një projekt i Qeverisë Shqiptare me Bankën Botërore ku përfshihet edhe transformimi i shërbimeve digjitale vendore. Gjithashtu, vlen të theksohet edhe fakti i miratimit të njw Grant Performance për bashkitë, me ligjin e buxhetit të vitit 2025⁴. Qëllimi i Grantit të Performancës, është të nxisë bashkitë të përmirësojnë proceset e qeverisjes në nivel vendor, që së bashku me kornizën e përmirësuar të politikave, të çojë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Ky fond akordohet bazuar në kritere performance duke ofruar incentiva për bashkitë për të përmirësuar performancën e tyre.

Në këtë kuadër, në mungesë të një analize të mëparshme nga ky këndvështrim, ky dokument synon të kontribuojë në identifikimin e nevojave prioritare dhe të ofrojë mbështetje për ndërhyrje më të rëndësishme të parashikuara në kuadrin e reformimit digjital të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Sekretariati i Këshillit të Investimeve (KI) ka trajtuar ndër vite problematika që lidhen me ndërveprimin e biznesit me pushtetin vendor, përfshirë dy çështje kryesore: në vitin 2020, u analizuan aspektet që lidhen me taksat dhe tarifën vendore si dhe roli i bashkive në zhvillimin ekonomik vendor; ndërsa në vitin 2018, u trajtua tematika e e-lejeve. Në këto dokumente⁵ u evidentuan problematika të ndryshme nga përdoruesit (biznese dhe bashki) që lidhen me respektimin e afateve, nivelin e tarifës së aplikimit, mekanizmat e informimit dhe njoftimit,

nevojën e harmonizimit të ligjeve sektoriale, zbatimin në praktikë të parimit të miratimit në heshtje, proceset e ankimit administrativ, etj. Në përgjithësi, pushteti vendor ka një avantazh unik për hir të faktit se është shumë afër komunitetit të biznesit apo qytetarit, duke mundësuar që palët të shohin më shpejt efektin dhe përfitimin e ndërveprimit cilësor dhe për pasojë të ndihen më të përfshirë e të angazhuar në kontributin që japin në komunitet. Megjithatë, përtej pavarësisë institucionale dhe ndarjes së kompetencave ndërmjet niveleve të pushtetit, mbetet për t'u adresuar pyetja: A mund të optimizohet ky avantazh përmes një ndërveprimi e bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe të strukturuar ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore, me qëllim sigurimin e aksesit të barabartë dhe cilësisë së shërbimeve administrative, si dhe përfitimit reciprok në nivel lokal?

Më specifikisht, në këtë dokument pune, fokusi është përqendruar në tre shtylla kryesore: a) **Barra administrative dhe kënaqësia e biznesit** kundrejt kostove të përfuturit të shërbimeve administrative dhe të tjera, b) **Identifikimi i shërbimeve administrative vendore** të cilat mund të konsiderohen me përparësi për digjitalizim, c) **Komunikimi fiskal dhe transparencë** – në vijim të diskutimeve të mëparshme mbi taksat dhe tarifën vendore, mekanizmat e njoftimit dhe ankimit, si dhe procedurat e lejeve elektronike. Ndërkohë, risi e kësaj analize janë gjithashtu gjetjet krahasuese 2019 dhe 2025, disa prej të cilave i referohen zhvillimeve në nivel vendor dhe të tjera në nivel qendror.

METODOLOGJIA

Hapat e ndërmarra nga Sekretariati për të evidentuar sfidat e biznesit ndaj transformimit digjital të shërbimeve vendore janë si më poshtë vijon:

- (i) *Hulumtimi i dokumentacionit strategjik dhe normativ*, përfshirë strategji kombëtare, ligje dhe akteve nënligjore të miratuara ndër vite, me ndikim në nivelin e vetëqeverisjes vendore dhe ofrimin e shërbimeve administrative;
- (ii) *Hulumtimi i raporteve ndërkombëtare dhe kombëtare*, të tilla si Raport Progresi i Komisionit Evropian, Vlerësimi mbi Sistemet e Menaxhimit Financiar të Bashkive, Raporti PEFA⁶, Raporti Vjetor mbi Financat Publike Vendore (Ministria e Performancës nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, etj.
- (iii) *Analiza e problematikave nga bizneset e*

veçanta dhe shoqatat e biznesit të depozituara në Sekretariat përgjatë periudhës 2015-2024.

- (iv) *Anketa e Sekretariatit shkurt 2025* – Anketa u realizua nëpërmjet një pyetësori të strukturuar dhe të shpërndarë online, ku morën pjesë në mënyrë rastësore dhe anonime 163 biznese.
- (v) *Konsultime direkte në nivel vendor* me përfaqësues të bashkive të Elbasanit; Korçës, Kolonjës, Durrësit, Lushnjës dhe Tiranës.
- (vi) *Konsultime në nivel teknik (fokus grupe)* me përfaqësues të bizneseve në Korçë dhe Durrës.
- (vii) *Fokus group me eksperte dhe shoqata biznesi* zhvilluar më 14 prill 2025 në Tiranë, me pjesëmarrjen e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, Shoqatës së Ndërtuesve, Shoqatës së Pasurive të Patundshme dhe shoqatave/aktorëve të tjerë të interesuar.

⁴ <https://financa.gov.al/buxheti-fillestar-2005/>

⁵ <https://www.investment.com.al/calendar-of-meetings/>; <https://www.investment.com.al/calendar-of-meetings/>

⁶ <https://pefa.org/country/albania>

KONTEKSTI

Në kushtet e proceseve të përshpejtuara të integrimit evropian të vendit, një ndër reformat strukturore më të rëndësishme konsiderohet reforma institucionale, që parashikohet të ketë një impakt të konsiderueshëm në rritjen ekonomike prej 0,7 %/vit,⁷ si dhe në nxitjen e investimeve në masën 0.5% në vit, duke lehtësuar përpjekjet për konvergencë me vendet anëtare të BE-së. Ndërkohë, si pjesë e iniciativës së Planit për Rritje për Ballkanin Perëndimor të BE-së, transformimi digjital theksohet si një ndër faktorët kyç të integrimit rajonal, ku projekti WiF-i4WB synon të lehtësojë sfidat infrastrukturore digjitale dhe të fuqizojë komunitetet lokale duke mundësuar akses më të madh në internet si edhe integrim në tregun evropian digjital. Më specifikisht, në raportin e fundit të Bankës Botërore⁸ “*Një agjendë ekonomike për të përshpejtuar konvergencën*”, theksohet se ndër masat që

do të përshpejtojnë rritjen ekonomike në vend është edhe forcimi i institucioneve dhe korniza qeverisëse me një vëmendje të veçantë ndaj digjitalizimit të shërbimeve dhe proceseve.

Po për çfarë digjitalizimi flasim? Sipas literaturës⁹, digjitalizimi në nivel vendor, si një proces ndërsektorial,¹⁰ përfshin ndërhyrje në disa shtylla kryesore që shtrihen përtej një sektori të vetëm. Këto shtylla përfshijnë: a) qeverisjen (vizioni, strategjitë, menaxhimi i burimeve njerëzore, iniciativat për digjitalizimin e shërbimeve, proceset e prokurimit dhe përdorimin e sistemeve digjitale), b) kornizat rregullatore (dije dhe nivel ndërgjegjësimit, si edhe politika në menaxhim të të dhënave dhe transparencës), c) infrastrukturën teknologjike (politika që sigurojnë pajisjet funksionale për administratën vendore, sistemet e ndërlidhjes së internetit dhe të energjisë), d) burimet njerëzore (politika, praktika mbi nivelin e përdorimit të shërbimeve digjitale, niveli i përdorimit të mjeteve digjitale, adoptimit

⁷ WB Report 27 March 2025: An economic agenda for accelerating convergence

⁸ An economic agenda for accelerating convergence, WB 2025

⁹ UNDP - 2024

¹⁰ Qeverisje Digjitale - termi

dhe niveli i aksesit), e) niveli i përdorimit të shërbimeve, i gjithëpërfshirjes apo edhe adoptimit të shërbimeve elektronike.

Sikurse përmendur më lart, analiza synon të identifikojë perspektivën e biznesit ndaj iniciativave të qeverisë në lidhje me transformimin digjital të shërbimeve administrative të pushtetit vendor. Për qëllime të analizës, hapi fillestar ka qenë identifikimi i një liste prioritare të shërbimeve administrative që njësitë e vetëqeverisjes vendore i ofrojnë biznesit. Bazuar në problematikat konkrete depozituar në Sekretariat nga disa shoqata, si edhe raporteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH-së) për bashki të ndryshme, u përgatit një përmbledhje e shërbimeve kryesore të ofruara për biznesin nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe disa shembuj pozitivë të digjitalizimit të shërbimeve dhe përpjekjeve të bëra ndër vite për përmirësimin e tyre. Kjo listë është edhe referencë për anketimin dhe konsultimet me grupet e interesit.

1. SHËRBIMET KRYESORE PËR TË CILAT SUBJEKTET I DREJTOHEN BASHKIVE

Më poshtë jepet një listë (jo-analitike) e shërbimeve për të cilat bizneset ndërveprojnë me njësitë e vetëqeverisjes vendore:

- » Regjistrimi fillestar i biznesit për efekt të taksave dhe tarifave vendore
- » Ç’regjistrimi i biznesit për efekt të taksave dhe tarifave vendore
- » Shërbimet Fiskale (Taksa dhe Tarifa – njofim i detyrimit dhe mënyra e llogaritjes, vlerësimi i detyrimit, koha e pagesës, pagesa online, etj.)
- » Ankimi administrativ (Taksa dhe Tarifa)
- » Leje për shfrytëzim të hapësirës publike
- » Shërbime të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
- » Shërbime të Mbrojtjes nga Zjarri dhe

Shpëtimi

- » Shërbime të Pastrimit (Përcaktimi i vendgrumbullimit të mbetjeve)
- » Shërbime të Transportit
- » Shërbime për Karburante
- » Marrje vërtetimesh (p.sh. për shlyerje detyrimesh, etj.)
- » Kërkesa/Ankesa
- » Lejet e ndërtimit dhe lejet e zhvillimit

2. PLATFORMA E-LEJET

Referuar sa më lart, platforma *e-Leje* përfaqëson një iniciativë “revolucionare” që u konceptua si mënyra e vetme e aplikimit për leje në fushën e ndërtimit dhe për rrjedhojë edhe unifikimit të procedurave për të 61 bashkitë e vendit. Kjo initiative u zbatua për të materializuar në praktikë legjislacionin e ri në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit si edhe në funksion të përmirësimit të renditjes sipas raportit *Doing Business* të Bankës Botërore. Platforma e-Leje u konceptua si një *dritare unike* ku institucione qendrore dhe lokale duhet të japin miratimin/refuzimin e tyre mbi dokumenta të depozituara nga aplikantët (projektuesit/zhvilluesit). Në këtë mënyrë, shumë dokumenta/konfirmime/vërtetime/autorizime të cilat duhet të merreshin përpara fazës së aplikimit në këto institucione, tani merren gjatë fazës së aplikimit, duke ulur barrën administrative në mënyrë të konsiderueshme për biznesin. Me gjithë problematikat teknike që shoqëruan implementimin e platformës në fazat e para të saj, apo sfidave aktuale, *pranohet gjerësisht se përmbledhja në një procedurë të vetme e hapave të nevojshëm të aplikimit për leje ndërtimi, mund të konsiderohet një rast suksesi i digjitalizimit të shërbimeve, edhe pse kohë pas kohe reflektohen probleme të natyrës praktike*.

3. DIGJITALIZIMI I SHËRBIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR BIZNESIN NGA BASHKIA TIRANË

Një nga shembujt konkretë të përparimit në digjitalizimin e shërbimeve administrative për biznesin është ndërmarrë nga Bashkia Tiranë, në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore. Ky shërbim digjital është i disponueshëm prej disa vitesh për bizneset, i cili aksesohet përmes kredencialeve të person-alizuara (*emër përdoruesi* dhe *fjalëkalimi*) në ndërfaqen përkatëse të Bashkisë Tiranë. Sot ndërfaqja mundëson aksesimin në kohë reale të të dhënave mbi detyrimet vjetore të taksave dhe tarifave vjetore sipas zërave përkatëse dhe faturës së arkëtimit shoqëruar me detajet e pagesës. Këto shërbime janë gjithashtu on-line edhe nëpërmjet platformës e-Albania nëpërmjet së cilës mundësohet edhe marrja e vërtetimeve për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore. Të njëjtat shërbime pritet të ofrohen edhe për qytetarët brenda një kohe të shkurtër.

4. NË NIVEL KOMBËTAR AKSESI I BIZNESIT NË SHËRBIME TË DIGJITALIZUARA TË VETËQEVERISJES VENDORE KA QENË SPORADIK, REZULTAT I INICIATIVAVE, PËRPJEKJEVE PSE JO DHE LOBIMIT TË SECILËS BASHKI.

Kështu, ndërkohë që Bashkia Tiranë ofron një pjesë të shërbimeve të saj në mënyrë të digjitalizuar për bizneset, të njëjtat shërbime nuk ofrohen në mënyrë të tillë nga bashkitë e tjera. Ndërsa një pjesë e bashkive ka digjitalizuar edhe njoftimin e gjobave të vendosura nga

bashkia për parkimet e gabuara të automjeteve (p.sh.: Bashkia Korçë, Bashkia Tiranë, etj.), kjo nuk i është mundësuar ende bashkive të tjera si p.sh. Bashkisë Elbasan. Ndërkohë, bashki të ndryshme kanë zbatuar dhe investuar në programe të ndryshme të raportimit të brendshëm financiar për Ministrinë e Financave (MF), si në rastin e Bashkisë Elbasan, e cila ka implementuar sistemin *SIFSHI* (Sistemi i Informacionit Financiar të Shërbimit të Hyrjes dhe Investimeve), ndërkohë që MF kërkon përdorimin e sistemit zyrtar kombëtar *AFMIS* (Albanian Financial Management Information System).

5. VLERËSIMI I GATISHMËRISË DIGJITALE TË BASHKIVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE NË SHQIPËRI¹¹

Ky raport është përgatitur në kuadër të hartimit të “Strategjisë ndër-sektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Lokale 2023–2030”, si një fazë paraprake drejt transformimit digjital të shërbimeve lokale. Raporti vlerësoi *Vlerësimin e Gatishmërisë Digjitale të Bashkive* dhe *Vlerësimin e Gatishmërisë Digjitale të Publikut*. Raporti evidenton se në nivel kombëtar kemi një nivel të kufizuar të gatishmërisë digjitale, me një rezultat mesatar (31/100), ndërsa në nivel lokal bashkitë përballen me sfida të mëdha në infrastrukturë, rregullore, qeverisje digjitale dhe ofrim shërbimesh ndaj përdoruesit ku përjashtim i vetëm është për Tiranën, me një rezultat të avancuar prej 73/100. Edhe për-sa i përket nivelit të popullatës, në nivel kombëtar, vlerësimi tregoi një rezultat mesatar prej 56/100, duke evidentuar një nivel të moderuar të gatishmërisë së popullatës.

¹¹ Ky Raport Fillestar është përgatitur nga IDRA Research & Consulting dhe Communication Progress në kuadër të aktiviteteve STAR3

KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

STRATEGJA NDËRSEKTORIALE PËR DECENTRALIZIMIN DHE QEVERISJEN VENDORE 2023–2030, PLANI I SAJ I VEPRIMIT 2023 – 2025 DHE PASAPORTA E INDIKATORËVE¹²

Strategjia përcakton midis të tjerave si qëllim politik të saj *zgjerimin e qeverisjes digjitale në nivel vendor për të ofruar shërbime dhe programe qeveritare në mënyrë më eficiente, transparente dhe me kosto efektive*.

Në këtë frymë, strategjia e re për decentralizimin dhe qeverisjen vendore synon konsolidimin e mëtejshëm të procesit të decentralizimit, shërbime cilësore e gjithëpërfshirëse dhe eficiencë e transparencë sipas standardeve evropiane. Këta objektiva synohet të arrihen nëpërmjet rritjes së kapaciteteve vendore, menaxhimit të integruar të aseteve vendore, përmirësimit të ofrimit të shërbimeve vendore, duke përfshirë *edhe digjitalizimin e shërbimeve vendore dhe përmirësimin e infrastrukturës së ofrimit të tyre*.

Qëllimi politik vendosi 2 objektiva specifikë:

Objektivi 1: Informimi i vendimmarrjes dhe përcaktimi i një udhërrëfyese të qartë për të gjitha nivelet dhe aktorët e përfshirë në Transformimin Digjital të Qeverisjes Vendore. Hartimi i këtij udhërrëfyese, i bazuar *në evidencë*, synon të adresojë sfidat dhe nevojat e qeverisjes vendore dhe të qytetarëve, dhe konsiderohet i një rëndësie të lartë.

Objektivi 2: Digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve vendore dhe integrimi i tyre në portalin e-Albania. Pas përfundimit të analizës së gatishmërisë digjitale, do të punohet paralelisht për *identifikimin e listës së plotë* të shërbimeve administrative dhe proceseve administrative që kryen çdo Njësi e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) në ofrimin e shërbimeve. Pas përfundimit të fazës së analizës për transformimin digjital të shërbimeve vendore, do të fillojë puna për digjitalizimin e ofrimit të shërbimeve online në portalin e-Albania, procedurave të brendshme të bashkive për trajtimin e aplikimeve dhe ofrimin e shërbimit përfundimtar vetëm elektronikisht, si dhe ngritjen e infrastrukturave përkatëse mbështetëse. Kjo do të nënkuptojë gjithashtu përdorimin dhe aplikimin e nënshkrimit dhe vulës elektronike, në procese të ndryshme të ofrimit të shërbimeve dhe digjitalizimin e procedurave të brendshme administrative.

¹² *Vendim i KM nr.252 date 20.4.2023*

CILAT JANË MASAT E PARASHIKUARA SIPAS STRATEGJISË:

- 1) Zbatimi i shërbimeve elektronike në platformën e-Albania
- 2) Zbatimi i sistemit të trajtimit dhe menaxhimit të aplikimeve
- 3) Krijimi i sistemit elektronik të rekordeve dhe dokumenteve elektronike
- 4) Zbatimi i sistemit e-inspektim
- 5) Zbatimi i sistemit e-gjopa për Policinë Bashkiake
- 6) Ngritja e sistemit online të taksave dhe tarifave vendore
- 7) Ngritja e sistemit financiar për menaxhimin e kontabilitetit dhe magazinës
- 8) Zhvillimi i faqeve zyrtare të unifikuara për çdo bashkie
- 9) Zbatimi i sistemit për menaxhimin e punëve publike
- 10) Ngritja e sistemit të akteve elektronike të Këshillit Bashkiak dhe botimit të tyre
- 11) Ngritja e infrastrukturës së qendëruar harduerike për sistemet TIK të pushtetit vendor
- 12) Koordinimi me NJVV dhe mbështetje për ofrimin sa më eficient të shërbimeve vendore në formë elektronike bazuar në procedura standarde të veprimit, udhëzime të ofrimit të shërbimit, etj.

Ofrimi online i shërbimeve vendore do të mundësojë qasje të pakufizuar dhe të barabartë për qytetarët dhe bizneset, duke përmirësuar ndjeshëm transparencën, përgjegjshmërinë dhe kohën e marrjes së shërbimeve. Çdo aplikim për shërbim do të jetë i gjurmueshëm dhe tërësisht transparent. Përmes mekanizmave të monitorimit, do të reduktohen vonesat në ofrimin e shërbimeve. Në portalin e-Albania do të ofrohen shërbime që janë riinxhinierizuar 100%, duke ofruar një shërbim tërësisht elektronik.

NGA PIKËPAMJA INSTITUCIONALE, KOORDINIMI DHE ZBATIMI I PROCESIT TË DIGJITALIZIMIT TË SHËRBIMEVE VENDORE, DO TË JETË MIDIS INSTITUCIONEVE:

- (i) Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor;
- (ii) Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
- (iii) AKSHI;
- (iv) Bashkitë;
- (v) Këshilli Konsultativ Qeverisje Qendrore – Vetëqeverisje Vendore

Ndërkohë, në mbledhjen e datës 24.12.2024 të Këshillit Konsultativ, u diskutua dhe u miratua projektvendimi “Për miratimin në parim të marrëveshjes së huasë nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin shtesë për digjitalizimin e shërbimeve publike të qeverisjes lokale dhe sistemit të prokurimit digjital të fuqizuar nga inteligjenca artificiale në kuadër të programit ‘Përmirësimi i aksesit universal në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet teknologjisë (Govtech)’”, propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor. Bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord, dhe mbështetur në diskutimet, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- » Të merret në konsideratë infrastruktura e dobët e bashkive si dhe të asistohen bashkitë për ngritjen e kapaciteteve.
- » Të garantohet mirëmbajtja e infrastrukturës digjitale.

PROBLEMATIKA TË EVIDENTUARA

1. PROBLEMATIKA TË REFERUARA NGA BIZNESI GJATË 2015-2024

Më poshtë jepen në mënyrë të përmbledhur tipologjitë kryesore të problematikave të komunitetit të biznesit në lidhje me shërbimet e ofruara nga bashkitë, të diskutuara gjatë takimeve të kryera nga Sekretariati gjatë periudhës 2015-2024. Këto problematika lidhen kryesisht me nivelin e taksave dhe tarifave vendore kundrejt cilësisë së shërbimit të ofruar; vendosjen e penaliteteve, veçanërisht në lidhje me mënyrën e bllokimit të llogarive dhe adresat; paligjshmërinë e perceptuar të taksës së përkohshme në arsim; mungesën e përfshirjes dhe informimit në vendimmarrjet e Këshillave Bashkiake, apo zbatimin e taksës për strehim. Më specifikisht, më poshtë jepet një listë e këtyre problematikave:

Taksat për biznesin e vogël - Të larta, jo proporcionale dhe vendosen mbi njësitë

tregtare sipas adresave sekondare dhe jo vetëm njëherë në emër të subjektit...

Bllokimi i llogarive bankare nga administrata tatimore është i pakoordinuar me Bankat e Nivelit të Dytë dhe penalizues për to dhe klientët (tatimpagues). Bllokimi i llogarive bankare personale të administratorit si mjet shtrëngimi për shlyerjen e detyrimeve nga shoqëria është praktikë abuzive...

Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore, tashmë është kthyer e përhershme. Ajo është e pabazuar në frymën e legjislacionit të ri për financat e vetëqeverisjes vendore...

VKB të papërditësuara dhe të papublikuara...

Ka probleme pa fund me adresat, ndërveprimi nëpërmjet e-Albania është problematik.

Niveli i taksave/tarifave dhe kthimi në shërbime cilësore tek biznesi janë në propocion të zhdrejtë...

Taksa e strehimit social është e padrejtë - Bashkia nxjerr në mënyrë të paligjshme akte nënligjore me VKB në një kohë që këto akte duhet të nxirren nga Qeveria...

Mungon transparenca mbi përdorimin e të ardhurave të mbledhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja...

Mungesa e bashkëpunimit me DRT Shkodër për formalizimin e bizneseve....

Taksat dhe Tarifat vendore per subjektet në fushën e agrobiznesit nuk janë të përshatshme...

2. GJETJE DHE ANALIZA

Gjetjet në këtë dokument janë rezultat i anketimit me 163 biznese gjatë periudhës janar - shkurt 2025, takimeve dhe fokus-grupeve me institucione të pushtetit vendor dhe qendror, bashki dhe biznese në qarqe të ndryshme të vendit (Elbasan, Korçë, Lushnjë, Kolonjë, Durrës, Tiranë) si edhe analizës së Sekretariatit. Sikurse përmendur më lart ato janë grupuar në: (a) Barra administrative dhe kënaqësia e biznesit kundrejt kostove të përfutimit të shërbimeve administrative dhe të tjera, b) Identifikimi i shërbimeve administrative vendore të cilat mund të konsiderohen me përparësi për digjitalizim, c) Komunikimi fiskal dhe transparenca.

2.1 DIGJITALIZIMI VENDOR - PERCEPTIME TË BIZNESIT MBI SFIDAT E DIGJITALIZIMIT NË NIVEL VENDOR

1. Në nivel strategjik, ende mungon apo nuk evidentohet roli i sektorit privat si aktor i rëndësishëm që kontribuon në proceset e zhvillimit lokal e për pasojë nuk shfaqet nje angazhim e vëmendje në drejtim të monitorimit të cilësisë së shërbimeve vendore të ofruara ndaj tij. Kështu, gjatë konsultimit të strategjive, dokumenteve dhe raporteve të publikuara në lidhje me njësitë e vetëqeverisjes vendore, vihet re **mungesa e identifikimit të treguesve të performancës ndaj shërbimeve që i ofrohen biznesit si një shtyllë themelore e mbështetjes dhe kontributit në të ardhurat e qeverisjes vendore dhe zhvillimin ekonomik vendor**. Theksojmë se sipas raportit të publikuar nga Qeveria Shqiptare në nëntor 2024¹³ mbi vlerësimin e performancës së bashkive theksohet se "...bashkitë me densitet të ulët biznesi, tregojnë një varësi më të lartë nga ndihma ekonomike". Ndërkohë, të ardhurat nga biznesi,¹⁴ si për shembull nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja përbëjnë 54,7% të taksave lokale të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe janë një faktor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomiko-social të tyre. *Sugjerojmë që bashkitë të kenë një angazhim më strategjik dhe më të*

¹³ <https://qeverisjavevendore.gov.al/ep-content/uploads/2024/11/Treguesit-e-performances-se-bashkive-nje-dekade-transformimi-nga-reforma-administrativo-territoriale.pdf>

¹⁴ Nuk mundëm të gjenim shifrën e saktë të të ardhurave të realizuara vetëm nga biznesi në asnjë raport të publikuar nga NJVQV

fokusuar në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit dhe komunikimit me komunitetin e biznesit.


2. Digjitalizimi perceptohet nga biznesi si instrument lehtësues kundrejt përfutimit të shërbimeve që ofron pushteti vendor (në analogji me eksperiencën e përfutuar nga shërbimet e digjitalizuara në nivel qendror), por mbetet i rezervuar në lidhje me përfutimet reale dhe efektivitetin në zbatim për shkak të nivelit të mbështetjes institucionale dhe profesionalizmit të administratës vendore. Kështu, pavarësisht se mirëpranohet nevoja e digjitalizimit, kërkohet që zbatimi i tij të jetë i *matur, gradual, i mirëmonitoruar/menaxhuar* që të lehtësojë gabimet që lidhen me ri-inxhinierimin e shërbimeve dhe të optimizojë cilësinë e ofrimit të këtyre shërbimeve.

- a. Në parim shumica e bizneseve shprehën në favor të zgjerimit të shërbimeve të digjitalizuara edhe në nivel vendor. Megjithatë, evidentohet se sportelet fizike vijojnë të jenë një kanal i preferuar në masë të konsiderueshme (47%), duke reflektuar një kërkesë të qëndrueshme për ndërveprim fizik në marrjen e shërbimeve nga ana e subjekteve. **Kështu, nisur nga praktikatat e deritanishme me shërbimet qendrore të digjitalizuara, shprehet nevoja e mbështetjes së ofrimit të shërbimeve digjitale edhe me zyra fizike** të dedikuara. Këto zyra do të shërbenin si pika asistence për bizneset, veçanërisht në:

- a) trajtimin e problematikave të përdorimit të sistemeve të reja; b) ofrimin e ndihmës në një fazë tranzitore (disavjeçare) drejt kalimit tërësisht digjital të shërbimeve publike. Një qasje e tillë do të mundësonte rritjen e kapaciteteve institucionale dhe të vetë bizneseve.

Figura 1. Ndërveprim digjital apo fizik

Do të dëshironit më shumë ndërveprim digjital (përfutim të shërbimeve online) me administratën e Bashkisë në vend të sporteleve fizike?




Burimi: Anketim i Sekretariatit, shkurt 2025

- a. **Pritshmëritë pozitive të biznesit mbi digjitalizimin e shërbimeve vendore argumentohen me impaktin në drejtim të uljes së barrës administrative, si rezultat i uljes së kostove, kohës së harxhuar apo burokracive të ndryshme.** Vlerësojmë se optimizmi mbështetet edhe nga eksperiencat/perceptimet e biznesit në lidhje me ndikimin e digjitalizimit të shërbimeve qendrore të cilat sipas tyre kanë sjellë reduktim të barrës administrative për ta.


Figura 2. Digjitalizimi dhe barra administrative

Në opinionin tuaj, marrja e shërbimeve publike administrative vendore në mënyrë elektronike (të digjitalizuar), do të ndihmojë në reduktimin e barrës administrative për kompaninë tuaj (kohën e harxhuar, kostot financiare, etj.) për të përfituar shërbime



Burimi: Anketim i Sekretariatit, shkurt 2025

Marrja e shërbimeve publike administrative në mënyrë elektronike a e ka reduktuar barrën administrative për kompaninë tuaj?




Burimi: Anketim Sekretariatit, qershor 2023

- a. **Minimizimi i kontaktit fizik me administratën** perceptohet se do të ndihmojë edhe në drejtim të uljes së korrupsionit bazuar në perceptimet e biznesit, rezultat i cili mbështetet edhe nga eksperiencia e biznesit në lidhje me uljen e korrupsionit si rezultat i digjitalizimit në nivel qendror.


Figura 3. Digjitalizimi dhe korrupsioni

Në opinionin tuaj, marrja e shërbimeve publike administrative vendore në mënyrë elektronike (të digjitalizuar), do të ndihmojë në reduktimin e praktikave korruptive për shkak të mungesës së kontaktit fizik me punonjësit e administratës vendore



Burimi: Anketim i Sekretariatit, shkurt 2025

Marrja e shërbimeve publike në mënyrë elektronike (të digjitalizuar), a i ka reduktuar praktikat korruptive në raport me institucionet?




Burimi: Anketim Sekretariatit, qershor 2023


3. **Zyrat me një ndalesë, të instaluar në rreth 52 bashki,¹⁵ kanë rezultuar pjesërisht të suksesshme sipas perceptimit të bizneseve, ku 39% e atyre që i kanë përdorur janë shprehur pozitivisht. Më specifikisht, si bizneset por edhe vetë bashkitë vlerëso-**

15 Projekti STAR 2&3

jnë lehtësimin e procedurave në trajtimin e shërbimeve të tipit Kërkesa/Ankesa në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ndoshta kjo edhe për faktin se ato krijuan një eksperiencë pozitive në sajë të kontaktit fizik. Gjithashtu nga konsultimet, edhe disa bashki vlerësuan ndikimin e zyrave me një ndalesë në mënyrën e gjenerimit dhe gjurmimit të shërbimit Kërkesa/Ankesa. Theksojmë se *referuar të dhënave të marra gjatë takimeve me bashki, sistemi i zyrave me një ndalesë që nga qershori i 2024 nuk është më funksional.*

Figura 4. Zyrat me një ndalesë (OSSH – One Stop Shop)

Nëse në 12 muajt e fundit i keni përdorur shërbimet e Zyrës me një Ndalesë (One Stop Shop) në bashki, sa të kënaqur jeni me eksperiencën tuaj:



Burimi: Anketim i Sekretariatit, shkurt 2025

4. Aktualisht, në nivel kombëtar, biznesi percepton se ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara nga njësitë e qeverisjes vendore ¹⁶ mbetet i kufizuar, ku vetëm rreth 30% e tyre ofrojnë akses online. Bashkia e Tiranës bën përjashtim pozitiv, pasi ofron disa shërbime online për bizneset. Më specifikisht, vetëm 3 në 10 kompani raportojnë se përdorin shërbime online të ofruara nga pushteti vendor, ndërkohë që për Bashkinë Tiranë ky tregues rritet në gati 1 në 2 kompani.

5. Nga takimet dhe konsultimet në rang bashkie, u arrit në përfundimin se **disa bashki¹⁷ në mënyrë individuale të mbështetura nga buxhetet e tyre dhe/ose partnerë për zhvillim kanë bërë përpjekje duke investuar në platforma e digjitalizim të proceseve të brendshme të punës, kryesisht për shërbime fiskale të ofruara biznesit dhe/ose qytetarëve.** Një pjesë e tyre ende i kanë në përdorim këto sisteme të cilat kryesisht i ndihmojnë në llogaritjen e detyrimeve fiskale, por ende nuk ofrojnë shërbime direkte për bizneset. *Mundësia e integritit të këtyre sistemeve me platformat kombëtare që planifikohen për digjitalizim e shërbimeve vendore, bazuar në planet dhe strategjitë qendrore, mund të merret në konsideratë duke patur parasysh edhe fondet e harxhuara në këtë drejtim.*

6. Aktualisht, Bashkia Tiranë ofron dy shërbime online për bizneset, (1) Njoftimi dhe mandat-arkëtimi mbi detyrimet fiskale të biznesit, dhe (2) Vërtetimi për shlyerjen e të gjitha detyrimeve


16 Shërbime të ofruara në platforma online të aksesuara direkt nga vetë bizneset

17 Bashkia Elbasan, Korçë, Lushnjë, etj.

fiskale vendore. Këto shërbime janë të integruara edhe në platformën e-albania, përveç ofrimit të tyre edhe në platformën e vetë bashkisë.¹⁸ Sipas Zyrës së Taksave Lokale të Bashkisë Tiranë, planifikohet që shumë shpejt ky shërbim do të jetë i mundshëm edhe për qytetarët të cilët do të mund të aksesojnë njoftim detyrimet fiskale në platformën e-albania.

Figura 5. Biznesi mbi përdorimin e platformave vendore online

Në 12 muajt e fundit, a keni përdorur për qëllime të biznesit, platforma të shërbimeve online të Bashkisë ku ushtroni aktivitetin tuaj ekonomik?



Burimi: Anketim i Sekretariatit, shkurt 2025


7. Platforma kombëtare e-lejet, aktualisht e integruar në platformën e-Albania funksionale që nga viti 2016 në të 61 bashkitë përmes një sistemi të qendëruar multifunksional të qeverisë qendrore, perceptohet si një eksperiencë pozitive në përfitim të shërbimeve vendore në mënyrë të digjitalizuar. 48% e

bizneseve të cilët e kanë përdorur këtë shërbim të digjitalizuar shprehen pozitivë në lidhje me eksperiencën e cila duket se u ka kursyer kohë në drejtim të përfitimit të shërbimit.


Ndërkohë, nga ana e bashkive u referua si problematik fakti se sistemi shpesh nuk funksionon siç duhet; ka mirëmbajtje herë pas here pa njoftim për bashkinë; për deklaratat paraprake krijon konfuzion për radhën e autorizimeve nëpërmjet specialistëve dhe përgjegjësve; nuk ka trajnime në vazhdimësi dhe nuk ka koordinim institucional. Gjithashtu, kërkesat për ndërtime në zonat rurale janë problematike sepse kërkohen shumë dokumenta ndërkohë që tarifa 3% është e lartë në raport me kapacitetet e fermerëve dhe koston e ndërtimit që ata duan të zhvillojnë në këto zona rurale.

Figura 6. Platforma e-Leje

Duke menduar për vizita të fundit që keni pasur me portalin e-lejet (Aplikimin për leje ndërtimi ne e-albania), sa të kënaqur ishit me gjithë eksperiencën?



I kënaqur/shumë i kënaqur




Burimi: Anketim i Sekretariatit, shkurt 2025

8. Bazuar në perceptimet e biznesit, prioritet në procesin e digjitalizimit në nivel vendor kanë shërbimet që lidhen me trajtimin e kërkesave

dhe ankesave, shërbimet fiskale si njoftimi, llogaritja e detyrimeve dhe kryerja e pagesave, si edhe procesi i ankimit administrativ.

Figura 7. Prioritizimi në digjitalizim

Cilat shërbime administrative të ofruara nga Bashkia mendoni se duhet të kenë prioritet në digjitalizim - më shumë prioritet



Burimi: Anketim i Sekretariatit, shkurt 2025


2.2 TË TJERA

9. Pavarësisht perceptimit të bizneseve se bashkitë kanë përmirësuar disi ofrimin e shërbimeve vendore, sërish evidentohen problematika përse i përket a) nivelit të komunikimit të njësive të vetë-qeverisjes vendore në drejtim të informimit, b) transparencës, c) përfshirjes në vendimmarrje dhe mungesës së fokusit ndaj komunitetit të biznesit si një nga “subvencionuesit” kryesorë të bashkive.


a. Vetëm 20% e bizneseve perceptojnë përmirësim të ofrimit të shërbimeve vendore në 12 muajt e fundit, ndërkohë që në përgjithësi ende 46% e tyre perceptojnë se komunikimi i NJVVQ është në nivele jo të kënaqshme.

Figura 8. Shërbimet dhe komunikimi vendor

Në 12 muajt e fundit a keni vënë re përmirësim (lehtësim) në përfitim e shërbimeve administrative të ofruara në Bashki?



Si e vlerësoni në përgjithësi komunikimin e bashkisë me bizneset?




Burimi: Anketim i Sekretariatit, shkurt 2025


b. Edhe pse bashkitë organizojnë konsultime publike, kryesisht në lidhje me paketat fiskale dhe hartimin e buxhetit vjetor të tyre, perceptimi ngelet se bashkitë nuk i kanë fokus të tyre bizneset, të cilët nuk ndihen të përfshirë në proceset vendimmarrëse që ndikojnë drejtpërsëdrejti veprimtarinë e tyre. Një nga arsyet e theksuara gjatë konsultimeve në terren në disa bashki, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në këto rezultate, është edhe mungesa e organizimit të bizneseve në grupe më të strukturuar apo dhoma, si përfaqësuese gjithëpërfshirëse të “zërit” të tyre. Mungesa e këtyre organizimeve i bën bizneset të jenë më pak të përfaqësuar, të informuar dhe ndikues në vendimet e NJVVQ dhe këshillave bashkiakë të tyre.

Figura 9. Mbi përfshirjen e komunitetit të biznesit në vendimmarrje

Sa shpesh bashkia organizon takime me bizneset për të diskutuar çështje të përbashkëta?



A ndiheni të përfshirë në proceset vendimmarrëse të bashkisë që ndikojnë biznesin tuaj?




Burimi: Anketim i Sekretariatit, shkurt 2025

c. Mungesa e informimit mbi vendimet më të fundit të këshillave bashkiakë dhe ndikimi i tyre në veprimtarinë e përditshme të biznesit theksohet si një sfidë e qenësishme nga komuniteti i biznesit në vend. Krahësuar me perceptimet e biznesit të vitit 2019, vihet re që kjo problematikë vazhdon në të njëjtat nivele. Edhe pse disa faqe interneti¹⁹ kanë të publikuara vendime të këshillave bashkiake dhe informacione të vlefshme mbi njësitë e vetë-qeverisjes vendore, për komunitetin e biznesit këto nuk janë të njohura. Madje shpesh gjatë takimeve u konkludua se biznesi nuk ndjek as faqet e internetit të bashkive për të marrë informacionet që mund t'u vlejsh. Organizimi i kufizuar apo mungesa e dhomave aktive të bizneseve në bashki të ndryshme, si edhe pavëmendshmëria e bashkive për t'u angazhuar në fushata informative për biznesin sjell mangësi në mos të qënurit të informuar mbi zhvillimet më të fundit.

Figura 10. Niveli i Informimi i komunitetit të biznesit

A ju informon Bashkia juaj në lidhje me vendimet më të fundit të Këshillave Bashkiakë dhe ndikimit të tyre në veprimtarinë tuaj?




Burimi: Anketime të Sekretariatit

19 www.portavendore.al; www.vendime.al; www.financatvendore.al


d. E njëjta situatë vërehet edhe përse i përket informimit dhe transparencës në lidhje me taksat dhe tarifatat si edhe procedurat administrative dhe masat shtrënguese të ndjekura nga bashkitë. Bizneset raportojnë mungesë informacioni të qartë dhe të aksesueshëm mbi këto tema, gjë që kontribuon më tej në sfidat me të cilat përballen në përmbushjen e rregulloreve dhe detyrimeve vendore.

Figura 11. Informimi mbi çështjet fiskale dhe procedurat


A jeni plotësisht të informuar në lidhje me taksat dhe tarifatat që i paguani Bashkisë?



Si e vlerësoni ju qartësinë e informacionit të ofruar nga Administrata Tatimore e Bashkisë në lidhje me procedurat administrative tatimore vendore?



A jeni të qartë mbi procedurën e masave shtrenguese që ndjek Administrata Tatimore e Bashkisë për mbledhjen e detyrimeve fiskale vendore?




Burimi: Anketime të Sekretariatit (2019, 2025)

e. Gjatë konsultimeve me komunitetin e biznesit, në ballafaqim të perceptimeve të marra nga pyetësorët, u theksua fakti se raporti midis cilësisë dhe kostos së shërbimeve publike vendore të ofruara nga bashkitë nuk është në nivele të kënaqshme. **3 në 5 kompani e vlerësojnë jo të drejtë balancën mes pagesave të kryera dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.** Megjithatë, krahasuar me nivelet e perceptimeve të vitit 2019 vihet re një përmirësim i konsiderueshëm në këtë drejtim.

Figura 12. Balanca Kosto/Përfitim

A e konsideroni të drejt balancën mes shërbimit të përfituar dhe tarifave vendore që paguani në Bashki?



Burimi: Anketime të Sekretariatit (2019, 2025)

f. Procedura e bllokimit të llogarive bankare nga Drejtoritë Vendore të Tatim-Taksave, një problematikë e referuar pranë Sekretariatit që në vitin 2019, perceptohet nga biznesi si më e konsoliduar, **por ende burokracitë dhe vonesat në urdhrat e zhbllokimit të llogarive krijojnë për biznesin vonesa të cilat sfidojnë veprimtarinë e përdishme të tij.** Gjatë konsultimeve u theksua mungesa e koordinimit institucional mes bashkive dhe Drejtorive Rajonale Tatimore në drejtim të shkëmbimit në kohë reale të informacionit në lidhje p.sh. mbi llogaritë bankare të bizneseve, të cilat tashmë raportohen në mënyrë të detyrueshme pranë organeve tatimore. *Nëse ky shkëmbim informacioni do të ndodhte në kohë reale, atëherë mund të ndihmonte minimalisht në reduktimin e kohës në lidhje me urdhrat e bllokim/zhbllokimit të cilat bashkitë do t'i dërgonin vetëm drejt atyre bankave ku biznesi disponon një llogari bankare dhe jo domosdoshmërisht tek të gjitha bankat e nivelit të dytë.* Vlen të theksohet se, ndonëse bizneset përmes sistemit të fiskalizimit deklarojnë në mënyrë të detyrueshme dhe në kohë reale xhirot e tyre, ky ritëm nuk është arritur të realizohet ndërmjet vetë institucioneve publike. Kjo mungesë ndërveprimi krijon ngërçe dhe sfida në marrëdhënien mes biznesit dhe institucioneve tatimore, si në nivel qendror, ashtu edhe vendor. Sa më sipër konfirmon edhe njëherë gjetjen e kahershme të Sekretariatit se, ndërsa teknologjia ofron mundësi dhe potenciale për më shumë efikasitet, ndërveprimi dhe koordinimi institucional mbeten problematikë dhe për rrjedhojë potencialet mbeten të pashfrytëzuara.

g. *Mungesa e koordinimit institucional me drejtoritë rajonale tatimore u theksua nga bashkitë si një nga arsyt kryesore që krijon sfida në lidhje me llogaritjet në kohë të taksave dhe tarifave vendore dhe jo vetëm.* Edhe pse bashkitë konfirmojnë ndjekjen e procedurave përmes sistemit qendror SQDNE me nënshkrim elektronik për komunikim me institucionet e tjera, ato nuk kanë akses në sistemet e këtyre institucioneve. Kjo përfshin, për shembull, pamundësinë për të parë online xhiron aktuale vjetore të tatimpaguesve apo të dhënat e pronësisë në sistemin e kadashtës. Si pasojë, shkëmbimi i informacionit në këto raste kryhet në formë shkresore, gjë që vështirëson proceset operacionale për klasifikimin e tatimpaguesve dhe përcaktimin e detyrimeve vjetore për taksë dhe tarifë. (Bashkia Elbasan, Bashkia Durrës).

h. **Mos-konsultimi i pushtetit qendror me pushtetin vendor për ligje/VKM të cilat ndikojnë edhe veprimtarinë e njësive të vetë-qeverisjes vendore shpesh krijojnë problematika që më pas përkthehen në ngërçe në marrëdhënien mes bashkive dhe bizneseve.** Një rast konkret i takon Bashkisë Tiranë ku një numër i konsiderueshëm biznesesh u ngarkuan me gjoba, kamatëvonesa dhe bllokim të llogarive bankare, për shkak të mosshlyerjes së detyrimit shtesë të taksës së ndërtesës për vitin 2023. Ky detyrim pasoi ndryshimet e bëra në muajin korrik 2023 në VKM nr. 132, datë 07.03.2018,²⁰ të cilat rishikuan

²⁰ VKM nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa" e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës"

çmimet e referencës për pasuritë e paluajtshme në territorin e Bashkisë Tiranë, pa u konsultuar më parë në Këshillin Konsultativ Qeverisje Qendrore-Vetëqeverisje Vendore. Zbatimi i çmimeve të reja të referencave i fillonte efektet nga muaji gusht 2023. Në pamundësi për ta mbledhur brenda vitit 2023, Bashkia e Tiranës me VKB nr. 35 datë 28 mars 2024, vendosi që diferenca e papaguar të bëhej brenda vitit 2024. Në total, rreth 30 mijë tatimpaguesve iu rillogarit taksë e pronës si pasojë e rishikimit të çmimeve të referencës në mesin e vitit 2023. Sipas Bashkisë Tiranë, njoftimi i këtij detyrimi iu njoftua tatimpaguesve me postë, ndërkohë që pretendohet se njoftimet kanë qenë të aksesueshme edhe në portalin e-Albania. Më shumë se gjysma e tatimpaguesve e shlyen detyrimin shtesë në kohë pa marrë penalitete dhe masa shtrënguese, ndërkohë që pjesa tjetër në mungesë të dënimisë dhe paqartësive, nuk arriti ta paguajë në kohë këtë detyrim, duke u përballur më pas me masa shtrënguese si bllokimi i llogarive bankare.


i. **Moskonsultimi i grupeve të interesit sa i përket vendimmarrjeve për hartimin e politikave fiskale në lidhje me transaksionet e pasurive të paluajtshme.** Specifikisht kjo çështje u ngrit nga NAR-EA në fokus group me eksperte dhe shoqata biznesi zhvilluar më 14 prill 2025. Sipas këtij grupi interesi problematikat lidhen me: (a) nuk është e qartë si dhe pse vendosen normat e caktuara të tatimit mbi këto transaksione; (b) si vlerësohet tregu dhe nivelet e çmimeve; (c) cila është metodologjia e vendosjes së çmimeve të referencës.

Zbatimi i taksimit të pasurive të paluajtshme dhe i transaksioneve me to, është element kyç dhe për të cilin deri më sot ka pak ose aspak informacion për aktorët e tregut. Rasti i rritjes së njëanshme të çmimeve të referencës në Tiranë në mes të vitit 2023 dhe pa një metodologji të konsultuar, është shembull konkret i mungesës së konsultimit, që sipas grupit të interesit ka shkaktuar anomali dhe deformime të shumta në treg, përfshirë dhe rritjen e informalitetit të sektorit.

- j. Rreth 54% e kompanive deklarojnë se janë vizituar nga inspektorët e bashkive dhe vetëm 23% e tyre deklarojnë se janë pak/aspak të kënaqur në lidhje me ndërveprimin me ta.

Figura 13. Inspektimet vendore

Nëse në 12 muajt e fundit jeni inspektuar nga inspektorët bashkiakë komentoni kënaqësinë me ndërveprimin me inspektorët:



Burimi: Anketim i Sekretariatit, shkurt 2025

- k. Gjatë konsultimit me bashki të ndryshme, doli në pah fakti se bashkitë po ndjekin një qasje racionale në procesin e regjistrimit të pronave në pronësi të tyre. *Bashkitë duke u fokusuar në interesin ekonomik të tyre, kanë prioritetizuar pronat që kanë*

potencial në gjenerimin e të ardhurave. Megjithatë, fakt është që një pjesë e madhe e pronave dhe aseteve të tyre mbeten ende të paregjistruara pavarësisht angazhimit publik që prej vitit 2020 për regjistrimin e të gjitha pronave shtetërore.

- l. Nga ana tjetër, nga monitorimi i treguesve të performancës të bashkive²¹, rezultojnë se kontributi i pushtetit vendor në drejtim të zhvillimit ekonomik lokal mbetet i kufizuar. Ky funksion, i cili është analizuar më herët edhe nga KI në vitin 2020,²² ende konsiderohet më i pak i zbatuari nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

2.3 KADASTRA FISKALE, PROGRESI DHE STATUSI AKTUAL

Në kuadër të ndjekjes sistematike të çështjeve të diskutuara edhe më parë,²³ Sekretariati i KI është rikthyer në analizimin e progresit dhe statusit aktual të zbatimit të Kadastrës Fiskale. *Edhe pse konceptimi dhe ndërhyrjet e para ligjore për Kadastrën Fiskale si një regjistër qendror i të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme të miratuara në vitin 2017,²⁴ ende sot, Kadastra Fiskale nuk është e zbatueshme. Aktualisht, bashkitë vijojnë të zbatojnë metodologjinë e re të taksimit të ndërtesave²⁵ bazuar në të dhënat e disponueshme në nivel vendor dhe jo sipas sistemit të Kadastrës Fiskale, i cili mbetet ende në proces kollauidimi.*

²¹ <https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Treguesit-e-performances-se-bashkive-nje-dekade-transformimi-nga-reforma-administrativo-territoriale.pdf>

²² www.investment.com.al/

²³ Mbledhje XIX e KI “Mbi Ndërveprimin Bashki-Biznes”, 27 Janar 2020

²⁴ Kadastra Fiskale u miratua si shprehje e vullnetit politik dhe si domosdoshmëri në përmbushje të rekomandimeve të FMN.

²⁵ VKM nr.132 datë 132 datë 07.03.2018

Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga DPTP në MF, sistemi informatik i Kadastrës Fiskale është vënë në dispozicion për 61 njësitë e vetëqeverisjes vendore të vendit që prej vitit 2018. Ky sistem u mundëson bashkive për të marrë informacion mbi ndërtesat nga tre burime kryesore: i) Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), ii) vetë-deklarimi i subjekteve, dhe iii) të dhënat ekzistuese të vetë bashkive. Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të funksionaliteve apo attributeve të sistemit, nisur dhe nga procesi i integritetit me databaza të institucioneve partnere, janë bërë përditësime dhe shtime të attributeve që lehtësojnë procesin e regjistrimit të njërive pronësore, gjenerimit të taksës dhe faturës përkatëse. Sistemi jep mundësinë e regjistrimit të taksave dhe tarifave të tjera vendore, pagesave dhe gjenerimit të raporteve të ndryshme siç mund të jenë: raporti i pagesës, taksimit apo progresit të punës në sistem. Sipas DPTP, problematikat e hasura gjatë përdorimit të Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale lidhen me:

- a. **Popullimi i pakët i Regjistrimit Qendror të të Dhënave.** Lidhur me procesin e popullimit të sistemit të Kadastrës Fiskale, si një detyrim i njërive të vetëqeverisjes vendore, përmbushja e tij rezultojnë të jetë në nivele shumë të ulëta. Si pasojë, në periudhën afatshkurtër, është parë si e nevojshme ndërhyrja me masa ndihmëse, përfshirë importimin e regjistrave të bashkive, si një hap parapërgatitor drejt krijimit të një databaze të mirëfilltë për administrimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme.
- b. **Vonesat në integrimin ndër-institucional të sistemeve:** Një tjetër pengesë për funksionimin optimal të Sistemit Informativ të Kadastrës Fiskale (SIKF) është mospërfundimi i integritetit të sistemit me bazat e të dhënave të institucioneve partnere. Konkretisht, shkëmbimi i të dhënave ende nuk është i plotë me: Agjencinë Kombëtare të Shfaqjes së Informacionit (AKSHI), Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC).

REKOMANDIME

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Bashkitë janë angazhuar tashmë politikisht dhe në nivel strategjik drejt një modeli të transformimit digital të shërbimeve administrative, i cili perceptohet pozitivisht për impaktin e tij edhe nga biznesi. Në këtë kontekst, mbetet e rëndësishme që të gjithë institucionet e përfshira dhe sidomos Bashkitë të qartësojnë hapat dhe mundësojnë një bashkëveprim cilësor me aktorët lokalë, përfshirë biznesin për të justifikuar pritshmëritë nga digjitalizimi i shërbimeve. Transformimi digjital mbetet sfidues dhe kushtëzohet nga një përgjegjshmëri institucionale në drejtim të planifikimit strategjik, angazhimit serioz për të siguruar gjithëpërfshirjen e aktorëve, dhe investimeve të qëndrueshme në inovacion e burime njerëzore.

REKOMANDIM 1.

Vizioni dhe lidhshirësi. Organet drejtuese të Qeverisjes Vendore, përtej angazhimit të qëndrueshëm politik dhe drejtimit të reformave për digjitalizimin, të hartojnë (a) **objektiva të qartë dhe tregues performance që konsiderojnë harmonizimin e interesave midis të gjithë aktoreve përfshirë edhe biznesin.** Cilësia e digjitalizimit të shërbimeve administrative vendore ndaj biznesit duhet të jetë pjesë e angazhimit strategjik, buxhetor, teknik e human. (b) **Formulimi i treguesve të performancës së shërbimeve ndaj biznesit dhe monitorimi i tyre, të jenë pjesë e planifikimit dhe raportimit periodik.**

REKOMANDIM 2.

Qasje e kujdesshme. **Mundësimi i një tranzicioni gradual dhe të matur nga zyrat fizike drejt digjitalizimit të shërbimeve vendore, i mirëkoordinuar brenda bashkive** (p.sh. task force me fokus digjitalizimin me përfaqësues nga seksione të ndryshme) me angazhimet buxhetore dhe upskilling do të rriste besimin dhe optimizimin e pritshmërive për cilësi të shërbimeve digjitale. **Nga sektori privat sugjerohet shoqërimi i digjitalizimit edhe me sportele fizike të dedikuara për bizneset e vogla (të integruara me sistemet digjitale të administratës publike) ku mund të jepet informacion**

e të trajtohen problematikat mbi aplikimet për licenca, leje ndërtimi, konsultime tatimore, etj., duke reduktuar vonesat. Si fazë e parë, **prioritet sugjerohet të kenë mundësimin online të kërkesave për informacion, deklarimeve tatimore, regjistrimeve të bizneseve, pagesave të tarifave, ankimeve, vërtetimeve, etj dhe ndërlidhjen me platformën kombëtare e-Albania.**

REKOMANDIM 3.

Institucionalizimi i koordinimit të investimeve publike dhe shkëmbimi i të dhënave. Investimet publike lokale në infrastrukturë dhe sisteme digjitale duhet të jenë të harmonizuara strategjikisht me platformat dhe iniciativat kombëtare, për të garantuar një koordinim institucional të sigurt, të besueshëm dhe të qëndrueshëm, veçanërisht në aspektin e shkëmbimit të të dhënave midis administratës qendrore tatimore dhe njërive të qeverisjes vendore. (a) **Duhet të vendoset një mekanizëm efikas dhe i sigurt për shkëmbimin në kohë reale të të dhënave ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe bashkive,** i cili do t'u mundësonte autoriteteve vendore të verifikojnë xhiron e bizneseve, të shmangin tatimin e dyfishtë dhe të sigurojnë njoftime tatimore të sakta dhe në kohë. Përdorimi i kontrolluar i bazave kombëtare të të dhënave tatimore nga punonjësit bashkiakë mund të përmirësojë ndjeshëm ofrimin e shërbimeve dhe mbledhjen e të ardhurave. (b) **Vendosja e sistemeve automatike të njoftimeve dhe sinjalizimeve ndër-institucionale do të ndihmonte në shmangien e vonesave dhe uljen e mosmarrëveshjeve administrative.** Për të rritur më tej transparencën dhe përfshirjen, bizneset duhet të mar-

rin njoftime automatike (p.sh., përmes email-it apo SMS-it) lidhur me projekt-vendimet e këshillave bashkiakë që mund t'i prekin drejt-përdrejt.

REKOMANDIM 4.

Kuadri rregullator. **Pushteti vendor duhet të sigurojë që procesi i digjitalizimit të zhvillohet në përputhje me një kornizë të qartë rregullatore që respekton parimet themelore etike dhe ligjore.** Kjo përfshin mbrojtjen e të dhënave personale dhe private, zbatimin e standardeve të sigurisë kibernetike si dhe garantimin e mbrojtjes së mjedisit gjatë zbatimit të teknologjive digjitale.

REKOMANDIM 5.

Nxitja e bashkëpunimit gjithëpërfshirës dhe ndërtimit të kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave lokale. Për të garantuar akses të barabartë dhe përfitime të shpërndara në mënyrë të drejtë nga iniciativat e zhvillimit lokal, është thelbësore të forcohet bashkëpunimi midis pushtetit vendor dhe sektorit privat, në veçanti me bizneset e vogla. Ky bashkëpunim duhet të bazohet në shkëmbimin e njohurive, trajnimitin e vazhdueshëm dhe dialogun gjithëpërfshirës, me fokus të veçantë në proceset e digjitalizimit dhe reformat e politikave fiskale. Më specifikisht, **ekziston një nevojë e qartë për përmirësimin e kuadrit ligjor që rregullon taksat dhe tarifat vendore.** Siç është evidentuar në mënyrë të përsëritur nga Këshilli i Investimeve, **sistemi aktual është i vjetëruar dhe nuk pasqyron në mënyrë adekuate zhvillimet socio-ekonomike dhe reformat politike të viteve të fundit.** Angazhimi i hershëm dhe i strukturuar me institucionet përkatëse është i domosdoshëm për të siguruar që perspektivat

dhe shqetësimet e komunitetit të biznesit të integrohen që në fazat fillestare të hartimit dhe rishikimit të legjislacionit në lidhje me tatimet vendore.

REKOMANDIM 6.

Forcimi i mekanizmave mbështetës për transformimin digjital të bizneseve. Duke pasur parasysh sfidat me të cilat përballen shumë ndërmarrje - veçanërisht bizneset e vogla - në kalimin drejt zgjidhjeve dixhitale, është thelbësore që dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit *të luajnë një rol aktiv në lehtësimin e tranzicionit dixhital*. Në partneritet me autoritetet lokale, ato duhet të investojnë së bashku në përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve. Këto përpjekje duhet të synojnë forcimin e pjesëmarrjes në hartimin dhe zbatimin e reformave lokale - veçanërisht ato që synojnë thjeshtimin e detyrimeve tatimore dhe uljen e barrierave burokratike. Avokimi duhet të mbështetet në analiza të bazuara në të dhëna dhe raste konkrete që pasqyrojnë ndikimet negative të procedurave të ndërlikuara. Po ashtu, duhet ofruar mbështetje

përmes trajnimeve të fokusuara, këshillimit dhe seminareve për zhvillimin e aftësive digjitale (duke përfshirë edhe IA), analizën e të dhënave, inovacionin dhe sipërmarrjen. Përdorimi efektiv i platformave kombëtare si e-Albania duhet të promovohet për të rritur aksesin në shërbime publike dhe për të ndërtuar një mjedis biznesi më konkurrues dhe modern.

REKOMANDIM 7.

Hartimi dhe zbatimi i një metodologjie të qëndrueshme dhe transparente për vlerësimin e pasurive të paluajtshme nëpërmjet një procesi të gjerë konsultues më grupet e interesit. Rekomandohet hartimi i një metodologjie të qëndrueshme dhe të standardizuar për vlerësimin e tregut dhe çmimet e referencës, në bashkëpunim me komunitetin e biznesit dhe organizatat profesionale. Kjo duhet të përfshijë: (i) ndarjen e zonave dhe nën-zonave kadastrale fiskale; (ii) përkufizimin e kriterëve për vlerësimin e tregut real; dhe (iii) hartën e re të vlerave, e cila të jetë publike, e arsyetuar dhe e përditësuar në mënyrë të rregullt.

BIBLIOGRAFIA

1. Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020
2. Raporti i Monitorimit të Strategjisë Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen
3. Vendore 2015-2020
4. Ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"
5. Ligji 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
6. 9632/2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (të ndryshuar)
7. Ligji 9975/2008 "Për Taksat Kombëtare" (të ndryshuar)
8. Ligji 9936/2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
9. Manual Praktik për procedurat e administrimit fiskal në njësitë e vetëqeverisjes vendore –
10. UNDP 2019
11. Raport Vjetor Financat Publike Vendore, 2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë
12. Fiscal Decentralisation Indicators for South-East Europe, NALAS December 2018
13. Qeverisja vendore në Shqipëri, Shoqta e Bashkive të Shqipërisë, 2019
14. Strategjia E Zhvillimit Të Qendrueshëm Të Bashkisë Tiranë 2018 – 2022
15. Apeli Tatimor në nivel vndor – Udhërfyes USAID 2018
16. Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) assessment of Berat Municipality, Albania
17. Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) assessment of Tirana
18. Municipality, Albania
19. Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) assessment of Tropojë
20. Municipality, Albania
21. Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) assessment of Fier
22. Municipality, Albania
23. Faqja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: eeë.financa.gov.al
24. Portali i Financave Vendore: www.financavendore.al
25. Portali i publikimit të VKB: www.vendime.al

PYETËSOR

PERCEPTIMI I NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI MBI DIGJITALIZIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE VENDORE

Kjo analizë synon të kuptojë a) nivelin e ndërgjegjësimit, b) pritshmëritë, c) gatishmërinë për të investuar dhe efektshmërinë në kuadrin e digjitalizimit të shërbimeve administrative në nivel vendor.

PROFILI I KOMPANISË

1. Sa vite keni në biznes:

- » <3 vite
- » 3 - 5 vite
- » 5 - 10 vite
- » >10 vite

2. Qarku ku kryeni aktivitetin tuaj:

- » Qarku i Beratit
- » Qarku i Dibrës
- » Qarku i Durrësit
- » Qarku i Elbasanit
- » Qarku i Fierit
- » Qarku i Gjirokastrës
- » Qarku i Korçës
- » Qarku i Kukësit
- » Qarku i Lezhës
- » Qarku i Shkodrës
- » Qarku i Tiranës
- » Qarku i Vlorës

3. Forma e organizimit të biznesit tuaj:

- » Person fizik
- » Shoqëri kolektive
- » Shoqëri komandite
- » Shoqëri me përgjegjësi të kufizua

- » Shoqëri aksionere
- » Degë e shoqërive të huaja
- » Zyrë përfaqësimi

4. Aksioneri/Ortaku/Pronari më i madh i biznesit tuaj është:

- » Femër
- » Mashkull
- » Preferoj të mos përgjigjem

5. Madhësia e biznesit tuaj sipas qarkullimit të vitit të fundit. Lutemi zgjidhni një opsion.

- » Deri në 10 milionë ALL
- » 10-14 milionë ALL
- » 14 - 50 milionë ALL
- » 50 - 250 milionë ALL
- » Mbi 250 milionë ALL

6. Cili është numri mesatar i punonjësve në biznesin tuaj:

- » Deri 9 punonjës
- » 10-49 punonjës
- » 50-249 punonjës
- » Mbi 249 punonjës

7. Aksionerët/Ortakët më të mëdhenj (me mbi 50% të aksioneve) të biznesit tuaj janë:

- » Vendas
- » Të huaj
- » Të përbashkët

8. Aktiviteti kryesor ekonomik i biznesit tuaj është:

- » Bujqësia, pyjet dhe peshkimi
- » Industria nxjerrëse
- » Industria përpunuese
- » Ndërtimi

- » Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave
- » Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar
- » Transporti dhe magazinimi
- » Akomodimi/Hoteleri
- » Shërbimi Ushqimor
- » Agjenci udhëtimi, operator turistik
- » Informacioni dhe Komunikacion
- » Shërbime

9. A jeni biznes eksportues?

- o Po
- o Jo

SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE

10. Në 12 muajt e fundit a keni vënë re përmirësim (lehtësim) në përfitim e shërbimeve administrative të ofruara në Bashki:

- » Po, është lehtësuar përfitimi i shërbimeve vendore
- » Jo, nuk ka pasur asnjë ndryshim të qënësishëm
- » Situata është përkeqësuar

11. Lutem komentoni përgjigjen më sipër:

12. Nëse në 12 muajt e fundit i keni përdorur shërbimet e Zyrës me një Ndalesë (One-Stop Shop) në bashki, sa të kënaqur jeni me eksperiencën tuaj:

- » Plotësisht të kënaqur
- » Disi të kënaqur
- » Neutral, nuk kanë sjellë ndonjë ndryshim

- » Pak të kënaqur
- » Aspak të kënaqur
- » Nuk i jam drejtuar asnjëhere zyrës me një ndalesë (One-Stop Shop)
- » Bashkia jonë nuk ka zyrë me një ndalesë (One-Stop Shop)

13. Do të dëshironit më shumë ndërveprim digjital (përfitim të shërbimeve online) me administratën e Bashkisë në vend të sporteleve fizike?
- » Po, tërësisht ndërveprim digjital
 - » Do të dëshiroja të kisha mundësinë e zgjedhjes mes shërbimeve online dhe sportelit fizik
 - » Jo, tërësisht sportele fizike

14. Lutem komentoni përgjigjen tuaj
-

15. Në opinionin tuaj, marrja e shërbimeve publike administrative vendore në mënyrë elektronike (të digjitalizuar), do të ndihmojë në reduktimin e barrës administrative për kompaninë tuaj (kohën e harxhuar, kostot financiare, etj. për të përfituar shërbimet)?
- » Po
 - » Jo
 - » Nuk e di

16. Në opinionin tuaj, marrja e shërbimeve publike administrative vendore në mënyrë elektronike (të digjitalizuar), do të ndihmojë në reduktimin e praktikave korruptive për shkak të mungesës së kontaktit fizik me punonjësit e administratës vendore?
- » Po

- » Jo
- » Nuk e di

17. Në 12 muajt e fundit, a keni përdorur për qëllime të biznesit, platforma të shërbimeve online të Bashkisë ku ushtroni aktivitetin tuaj ekonomik?
- » Po
 - » Jo
 - » Bashkia nuk ofron platforma të shërbimeve online
 - » Nuk e di, nuk kam informacion

18. Duke menduar për vizita të fundit që keni pasur, sa të kënaqur ishit me gjithë eksperiencën?
- » Plotësisht i kënaqur
 - » Disi i kënaqur
 - » Neutral
 - » Pak i kënaqur
 - » Aspak i kënaqur

19. Lutem komentoni përgjigjen tuaj
-

20. A e keni përdorur portalin e-lejet (Aplikimin për leje ndërtimi në e-Albania):
- » Po
 - » Jo

21. Duke menduar për vizita të fundit që keni pasur me portalin e-lejet (Aplikimin për leje ndërtimi në e-Albania), sa të kënaqur ishit me gjithë eksperiencën?
- » Plotësisht i kënaqur
 - » Disi i kënaqur
 - » Neutral

- » Pak i kënaqur
- » Aspak i kënaqur
- » Nuk kam aplikuar tek e-lejet

22. Duke menduar për vizita të fundit që keni pasur me portalin e-lejet (aplikimin për leje ndërtimi në e-Albania), vlerësoni kënaqësinë në lidhje me shërbimin specifik të përfituar ku 1-shume i/e pakënaqur dhe 5-shumë i/e kënaqur:
- » Aplikim për lëshimin e një leje zhvillimi pranë Njësive të Qeverisjes Vendore
 - » Aplikim për leje ndërtimi për ndërtime të reja apo shtesa, me sipërfaqe të përgjithshme deri në 250 m² pranë Njësive të Qeverisjes Vendore
 - » Aplikim për leje ndërtimi pranë Njësive të Qeverisjes Vendore
 - » Aplikim për leje për prishje ndërtimi pranë Njësive të Qeverisjes Vendore
 - » Kërkesë për lëshimin e deklaratës paraprahe për kryerje punimesh
 - » Për kërkesën për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit pranë Njësive të Qeverisjes Vendor
 - » Aplikim për lëshimin e lejes për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit
 - » Aplikim për lëshimin e lejes për ndryshimin e aktiviteteve dhe/ose funksioneve të njësive individuale
 - » Kërkesë për lëshimin e certifikatës së përdorimit
 - » Aplikim për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit pranë Njësive të Qeverisjes Vendore.

23. Lutem komentoni pse
-

24. Cilat shërbime administrative të ofruara nga Bashkia mendoni se duhet të kenë prioritet në digjitalizim? Vlerësoni nga 1 (pak) deri në 5 (shumë):
- » Regjistrimi fillestar i biznesit për efekt të taksave dhe tarifave vendore
 - » Ç'regjistrimi i biznesit për efekt të taksave dhe tarifave vendore
 - » Shërbimet Fiskale (Taksa dhe Tarifa – njoftim i detyrimit dhe mënyra e llogaritjes, vlerësimi i detyrimit, koha e pagesës, pagesa online, etj.)
 - » Ankimi administrativ (Taksa dhe Tarifa)
 - » Leje për shfrytëzim të hapësirës publike
 - » Shërbime të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
 - » Shërbime të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
 - » Shërbime të Pastrimit (Përcaktimi i vendgrumbullimit të mbetjeve)
 - » Shërbime të Transportit
 - » Shërbime për Karburante
 - » Aplikim për tendera dhe prokurime
 - » Marrje vërtetimesh (p.sh., për shlyerje detyrimesh, etj.)
 - » Kërkesa/Ankesë
 - » Tjetër _____

25. Lutem komentoni përgjigjen tuaj
-

26. Cilat shërbime të bashkisë ju krijojnë më tepër problematika gjatë përfutimit të tyre në terma të kohës, dokumentacioni të kërkuar, etj.: _____

27. Komente të tjera në lidhje me digjitalizimin vendor: _____

NDËRVEPRIMI BASHKI - BIZNES

28. Si e vlerësoni komunikimin e bashkisë me bizneset

- » Shumë i mirë
- » I mirë
- » I kënaqshëm
- » I dobët
- » Shumë i dobët

29. Sa shpesh bashkia organizon takime me bizneset për të diskutuar çështje të përbashkëta?

- » Shumë shpesh
- » Ndonjëherë
- » Rrallë
- » Kurrë

30. A jeni plotësisht të informuar në lidhje me taksat dhe tarifat që i paguani Bashkisë?

- » Jo, nuk jam i informuar
- » Pjesërisht, jam i informuar për taksat/tarifat por nuk jam i informuar për mënyrën e llogaritjes
- » Po, jam plotësisht i informuar

31. Si e vlerësoni ju qartësinë e informacionit të ofruar nga Administrata Tatimore e Bashkisë në lidhje me procedurat administrative tatimore vendore?

- » Shumë i qartë
- » I qartë
- » I paqartë

32. A e konsideroni të drejtë balancën mes shërbimit të përfituar dhe tarifave vendore që paguani në Bashki?

- » Pak ose Aspak

- » Mjaftueshëm
- » Plotësisht
- » Nuk e di

33. Lutem komentoni për më lart

34. A ju informon Bashkia juaj në lidhje me vendimet më të fundit të Këshillave Bashkiakë dhe ndikimit të tyre në veprimtarinë tuaj?

- » Po, bashkia na informon
- » Jo, bashkia nuk na informon

35. A ndiheni të përfshirë në proceset vendim-marrëse të bashkisë që ndikojnë biznesin tuaj?

- » Po, gjithmonë
- » Ndonjëherë
- » Jo, kurrë

36. A jeni të qartë mbi procedurën e masave shtrënguese që ndjek Administrata Tatimore e Bashkisë për mbledhjen e detyrimeve fiskale vendore?

- » Shumë i qartë
- » I qartë
- » I paqartë

37. Nëse jeni të paqartë detajoni përgjigjen tuaj:

38. A keni hasur problematika me bllokimin e llogarive tuaja bankare nga ana e administratës tatimore të bashkisë tuaj?

- » Po
- » Jo

39. Lutem komentoni përgjigjen tuaj:

40. Nëse në 12 muajt e fundit jeni inspektuar nga inspektorët bashkiakë komentoni kënaqësinë me ndërveprimin me inspektorët:

- » Plotësisht i kënaqur
- » Disi i kënaqur
- » Neutral
- » Pak i kënaqur
- » Aspak i kënaqur
- » Nuk kam patur vizita të inspektorëve të bashkisë në 12 muajt e fundit

41. Çfarë përmirësimesh do të dëshironit nga bashkia për të ndihmuar bizneset?

- » Informimi dhe transparenca në fushën e taksave
- » Lehtësim i procedurave administrative
- » Përmirësim i infrastrukturës
- » Mbështetje financiare
- » Organizim i aktiviteteve promovuese për bizneset lokale
- » Trajnime dhe informacione për zhvillimin e biznesit
- » Tjetër

Komente të tjera në lidhje me ndërveprimin bashki – biznes: _____

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha


Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjëse për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council



Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).